



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 23452 Prot.

Tiranë, më 19/12/ 2019

**UDHËZIM**

Nr. 37 Datë 19.12 2019

**“PËR**

**PROCEDURAT E MBYLLJES SË LLOGARIVE VJETORE TË BUXHETIT PËR  
VITIN 2019”**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 62 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe pikës 272 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”:

**UDHËZOJ:**

**I. PËRMBAJTJA DHE PUBLIKIMI I PASQYRËS FINANCIARE VJETORE TË  
KONSOLIDUAR TË SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURAVE TË QEVERISJES  
SË PËRGJITHSHME:**

1. Për llogari të Buxhetit të Shtetit të vitit 2019, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen:
  - a. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara, të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) nga data 01.01.2019 deri më 31.12.2019 (duke përfshirë datën 31.12.2019) si dhe arkëtimet e kontributeve vullnetare të kontabilizuara në llogarinë ekonomike 7207013 – “Donacione për emergjencat dhe fatkeqësi natyrore”, çelur në planin kontabël posaçërisht për gjendjen e shpallur të fatkeqësisë natyrore dhe emergjencës nga Këshilli i Ministrave, të cilat trashëgohen dhe përdoren në vitin 2020 për financimin e shpenzimeve të jashtëzakonshme;

- b. Të gjitha shpenzimet publike (përfshirë edhe shpenzimet nga nënhuatë e raportuara nga njësitë e zbatimit të projekteve të financimit të huaj dhe të konfirmuara nga struktura përgjegjëse për borxhin publik) të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2019 deri më 31.12.2019 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të regjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2019, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave.
  - c. b/1 Në aneks të veçantë të raportohen të dhënat e detajuara sipas klasifikimit ekonomik (llogaritë ekonomike 600, 601, 602, etj.) të shpenzimeve kapitale me financim të huaj (llogaria ekonomike 230), të cilat raportohen në total kundrejt planit të buxhetit të treguesve fiskalë të konsoliduar, të regjistruar në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ).
  - d. b/2 Në aneks të veçantë të raportohen të dhënat e detajuara për shpenzimet dhe pagesat e detyrimeve të prapambetura sipas treguesve fiskalë të konsoliduar. Në klasifikimin e detajuar të zërave agregat të detyrimeve të prapambetura, në zbatim të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të shtohet zëri: “Detyrime të prapambetura për mallra”. Gjithashtu, zëri “Detyrime të prapambetura të tjera” të detajohet deri në nivelin e të dhënave të raportuara për treguesit fiskalë të konsoliduar.
2. Për llogari të buxhetit të shtetit 2019 në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, në seksionin e financimit të deficitit fiskal të përfshihen të gjitha transaksionet e regjistruara në SIFQ si më poshtë:
- a. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara nga shitja/privatizimi i aktiveve afatgjata publike gjatë vitit 2019;
  - b. Të gjitha arkëtimet e lidhura me huamarrjen e huaj deri në fund të datës 31.12.2019;
  - c. Të gjitha ri-pagesat e borxhit të jashtëm të kryera deri më datë 31.12.2019;
  - d. Ndryshimi i gjendjes së mjeteve monetare në të gjitha llogaritë e çelura nga ministri përgjegjës për financat në Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë;
  - e. Gjendja e likuiditeteve në udhëtim që figurojnë si të tilla në fund të datës 31.12.2019.
  - f. Fitimi/humbja që rezulton nga transaksionet e këmbimit të mjeteve monetare ndërmjet nënllogarive në monedhat LEK, EURO, USD dhe SDR të llogarisë së unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” (TSA) në Bankën e Shqipërisë si dhe ato të zhvlerësimit/rivlerësimit periodik të gjendjes vjetore të mbartur (balanca e llogarive të planit kontabël 657, 767, 766, etj.) të raportohen në nënzërin “Balanca nga kursi i këmbimit” të zërit “Të tjera” të burimeve të brendshme të financimit të deficitit.
3. Për efekt të paraqitjes në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, fondet e planifikuara dhe të realizuara në

kapitullin 08 për paga dhe sigurime, do të pasqyrohen në zërin “Shpenzime operative e mirëmbajtje”, sipas programeve dhe ministrive si më poshtë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë:
    - Programi 04130 “Mbështetje për zhvillim ekonomik”.
  - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë:
    - Programi 09450 “Arsimi Universitar”;
    - Programi 09770 “Fonde për shkencën”.
  - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:
    - Programi 07330 “Shërbimet e Kujdesit Dytësor”.
4. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër përgatit të dhënat faktike përfundimtare të pasqyrës vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme brenda datës 14.02.2020.
  5. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të njërive të qeverisjes së përgjithshme publikohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në muajin shkurt 2020.
  6. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme e shoqëruar me raportin përfundimtar të gjendjes faktike të shpenzimeve dhe të ardhurave të Buxhetit të Shtetit 2019, i paraqitet Këshillit të Ministrave brenda muajit maj të vitit 2020.

## **II. MARRËDHËNIET E MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË ME BANKAT E NIVELIT TË DYTË**

7. Në zbatim të marrëveshjes me ministrinë përgjegjëse për financat, bankat e nivelit të dytë kryejnë arkëtime të fondeve publike për llogari të vitit 2019 deri në fund të vitit 2019. Bankat e nivelit të dytë transferojnë në Bankën e Shqipërisë brenda orës 10:00 të datës së parë të punës në muajin Janar 2020, të gjitha mjetet monetare të arkëtuara për buxhetin e shtetit deri në fund të vitit 2019. Llogaritë e degëve të thesarit në bankat e nivelit të dytë do të fillojnë me gjendje zero në vitin 2020.
8. Degët e Thesarit përfundojnë rakordimin me bankat e nivelit të dytë dhe raportojnë elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër brenda datës 10.01.2020.
9. Sistemimet që nuk kanë ndikim në balancën e llogarisë unike të thesarit, do të kryhen në SIFQ nga vetë degët e thesarit dhe degët e bankave të nivelit të dytë, pa konfirmim nga struktura e thesarit në qendër.
10. Përmbledhëset për sistemimet, të cilat kanë ndikim në balancën e llogarisë unike të thesarit, do të paraqiten elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër deri më datën 15.01.2020 dhe do të kryhen nëpërmjet SIFQ me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Informacioni elektronik do të shoqërohet me akt-rakordimin e skanuar të mbajtur midis degës së thesarit dhe degës së bankës së nivelit të dytë.

11. Bankat e nivelit të dytë, para konfirmimit përfundimtar të rakordimit vjetor me strukturën përgjegjëse të Bankës së Shqipërisë dhe me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë, duhet të sqarojnë më parë mosrakordimet e mundshme me subjektet që operojnë dhe mënyrën e sistemimit të tyre.
12. Drejtoritë qendrore të bankave të nivelit të dytë rakordojnë me strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër sipas formatit të dërguar nga kjo e fundit brenda datës 17.01.2020.

### **III. MARRËDHËNIET E MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË ME BANKËN E SHQIPËRISË**

13. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të urdhërojë kryerjen e pagesave në Bankën e Shqipërisë deri në fund të sesionit të tretë të pagesave të datës 31.12.2019.
14. Llogaria “Depozitë e Qeverisë” dhe të gjitha llogaritë speciale të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë në Bankën e Shqipërisë në ditën e parë të punës të muajit Janar të vitit 2020, do të mbartin tepricën e mbylljes së këtyre llogarive në fund të vitit.
15. Procesi zyrtar i rakordimit me Bankën e Shqipërisë për arkëtimet dhe pagesat e qeverisjes së përgjithshme të kryera për vitin 2019 fillon në ditën e parë të punës të muajit Janar të vitit 2020. Më datën 21.01.2020 konfirmohet akt-rakordimi paraprak dhe më datën 08.02.2020 konfirmohet akt-rakordimi përfundimtar midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë.
16. Struktura përgjegjëse për borxhin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë përfundon regjistrimin në SIFQ të transaksioneve të borxhit të brendshëm dhe borxhit të jashtëm për vitin 2019, brenda datës 17.01.2020.
17. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër përgatit brenda datës 24.01.2020 raportin përfundimtar të hyrjeve dhe daljeve të llogarisë bankare “Depozitë e Qeverisë”, për të cilën merr konfirmimin zyrtar nga Banka e Shqipërisë.

### **IV. MARRËDHËNIET E MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË ME NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME**

18. Bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme do të urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve në degët e thesarit deri në ditën e fundit të punës, më 26.12.2019, përveç rasteve për të cilat është miratuar afat specifik nga ministri përgjegjës për financat. Dega e thesarit kryen kontrollet sipas legjislacionit në fuqi lidhur me vlefshmërinë e fondeve dhe ekzistencën e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur dhe të marrë në dorëzim brenda datës 27.12.2019 (fatura e furnitorit duhet të jetë gjeneruar brenda muajit dhjetor të vitit 2019).
19. Për transfertat e fondeve buxhetore me formën e pagesës letër-kredi (LC) për kontrata të rëndësishme të veçantë (në zbatim të pikës 160 dhe 161 të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018

- “Depozitë e Qeverisë” në llogarinë bankare të veçantë të njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme në një nga bankat e nivelit të dytë, në treguesit fiskalë të konsoliduar të qeverisjes së përgjithshme përfshihet gjendja bankare e fundit të vitit në zërin “Të tjera” të burimeve të financimit të brendshëm të defiçitit.
20. Dega e thesarit Tiranë përfundon rakordimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe raporton në strukturën përgjegjëse të thesarit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë brenda datës 15.01.2020.
  21. Njësitë e Projekteve me Financime të Huaja, ISSH dhe FSDKSH dorëzojnë raportin përfundimtar të të ardhurave e shpenzimeve në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër brenda datës 15.01.2020.
  22. Brenda datës 24.01.2020 degët e thesarit rakordojnë me njësitë e qeverisjes së përgjithshme për shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2019. Gjatë procesit, degët e thesarit duhet të rakordojnë me njësitë e qeverisjes së përgjithshme për statusin e ekzekutimit të çdo kontrate duke respektuar udhëzimin e operacioneve ditore në SIFQ.
  23. Në rastet e konstatimeve të gabimeve të regjistrimeve në sistem të shkresave të ndryshimit të planit vjetor të Buxhetit të Shtetit të vitit 2019, degët e thesarit i raportojnë si të tilla në strukturën përgjegjëse për buxhetin dhe strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër, të cilat bëjnë sistemimet përkatëse. Për çdo mospërputhje të këtyre planeve në nivel programi, projekti, kapitulli dhe llogari ekonomike do të bëhen sistemimet me strukturën përgjegjëse për buxhetin, e cila përgatit akt-rakordimin paraprak elektronik me njësitë e qeverisjes qendrore për planin përfundimtar të vitit 2019 deri më datën 23.01.2020.
  24. Degët e thesarit për arkëtimet e vitit 2019, në favor të njësisë të përgjithshme (fonde të cilat në zbatim të legjislacionit përdoren nga njësia e qeverisjes së përgjithshme dhe trashëgohen në vitin 2020), mbartin tepricën e fondeve të papërdorura të të ardhurave të vitit 2019, në strukturat buxhetore përkatëse pas përfundimit të rakordimit të degës së thesarit me njësinë respektive të qeverisjes së përgjithshme.
  25. Mbartja e fondit të grantit të arsimit të lartë të papërdorur gjatë vitit 2019, do të bëhet sipas procedurës si më poshtë:
    - a. Të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë rakordojnë me Degët e Thesarit lidhur me fondet e papërdorura gjatë vitit 2019 për grantin e arsimit të lartë përkatësisht në strukturat:
      - Grupi 11, Programi 09450, Kapitulli 08, Artikujt 600, 601, 602, 604, 605 dhe 606.
      - Grupi 11, Programi 09770, Kapitulli 08, Artikujt 600, 601, 602, 604, 605 dhe 606.
    - b. Një kopje e këtij akt-rakordimi paraqitet pranë nëpunësit të parë autorizues për t’u mbartur në të njëjtën strukturë buxhetore në vitin pasardhës.
  26. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër publikon të dhënat faktike të detajuara në nivel njësie shpenzuese sipas strukturës buxhetore, në faqen elektronike zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë brenda muajit janar të vitit 2020.
  27. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rakordon me njësitë e qeverisjes qendrore, planin e buxhetit të shtetit të vitit 2019 në nivel grupi, programi, produkti, kapitulli dhe artikulli, përfshi edhe limitin e përdorimit të të ardhurave të institucioneve buxhetore. Gjithashtu, njësitë e qeverisjes qendrore, duhet të raportojnë shumën e shpenzimeve të realizuara nga të ardhurat jashtë limitit.

28. Të dhënat e detyrimeve të prapambetura të rakordohen brenda muajit janar të vitit 2020 midis njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme dhe degëve të Thesarit, të cilat menjëherë raportojnë në strukturat përgjegjëse për Buxhetin dhe Thesarin në qendër sipas formatit të raportit të gjeneruar nga SIFQ. Të dhënat e faturave të detyrimeve të prapambetura të mbajtura në listëpagesën e pagave (sigurimeve shoqërore, shëndetësore etj.) të regjistrohen në periudhat e vitit 2020 në përputhje me grafikun e shlyerjes së paraqitur në zbatim të shkresës nr. 19254, datë 25.10.2019 të ministrit përgjegjës për financat.
29. Procesi i regjistrimit në SIFQ dhe rakordimit me kreditorët për financimet e huaja midis strukturave përgjegjëse të thesarit, borxhit dhe njësive të qeverisjes së përgjithshme duhet të përfundojë brenda datës 13.02.2020.
30. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojnë brenda fundit të vitit fondet e papërdorura në vitin 2019, të detajuara sipas burimeve të financimit si më poshtë:
  - a. Nga granti i qeverisjes qendrore, në Kapitullin 1 “Çelje nga buxheti”;
  - b. Nga projektet me financim të huaj, në Kapitullin 2 “Financimi i Huaj”;
  - c. Nga të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së tyre, në Kapitullin 5 “Të ardhurat e veta”;
  - d. Nga të ardhurat e krijuara në zbatim të legjislacionit specifik, në Kapitullin 6 “Të ardhurat jashtë limitit”.

## **V. RAKORDIMI DHE MBYLLJA E LLOGARIVE TË TJERA VJETORE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME**

31. Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimi i pasqyrave financiare do të kryhet në bazë të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
32. Degët e thesarit gjenerojnë nga sistemi i SIFQ brenda muajit janar të vitit 2020 (në varësi të afatit të përfundimit të rakordimit vjetor) informacionin financiar disponibël/pasqyra financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë. Të dhënat përfundimtare kontabël pasqyrohen në SIFQ (në periudhën e 13-të) nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë, në zbatim të manualeve përkatëse.
33. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme me vetëfinancim hartojnë pasqyrat financiare vjetore sipas formatit të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë (pika 31 e këtij udhëzimi) në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë (e cila vë në dispozicion të dhënat elektronike ekzistuese në SIFQ deri në fund të muajit janar të vitit 2020). Të dhënat përfundimtare të pasqyrave financiare vjetore 2019 paraqiten brenda muajit mars të vitit 2020, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë dhe në struktura përgjegjëse për statistikat pranë INSTAT-it.
34. Njësitë e projekteve me financim të huaj raportojnë në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë të dhënat e munguara të pasqyrave financiare për periudhën e mëparshme deri në

31.01.2020.

35. Struktura përgjegjëse për borxhin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të raportojë në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër të dhënat e pasqyrave financiare të vitit 2019 për borxhin e Qeverisë Qendrore brenda muajit mars të vitit 2020. Gjithashtu, struktura përgjegjëse për borxhin brenda datës 31.03.2020 duhet të raportojë në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër të dhënat e vitit 2019 për nënhuatë.
36. Strukturat përgjegjëse për kontabilitetin në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “online” me SIFQ të saktësojnë të dhënat e inventarëve të aseteve jofinanciare dhe të raportojnë të dhënat e munguara të migrimit në strukturën përgjegjëse për Thesarin në qendër për t’i ngarkuar në SIFQ, duke mundësuar gjenerimin e të dhënave të konsoliduara të pasqyrave financiare të përputhura me të dhënat e paraqitura fizikisht (“hard copy”) në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë.
37. Pas përfundimit të gjenerimit të të dhënave të konsoliduara të pasqyrave financiare vjetore 2019, struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër, në bashkëpunim me INSTAT dhe Bankën e Shqipërisë (në zbatim të memorandumit të përbashkët të mirëkuptimit) harton deri në fund të muajit maj të vitit 2020 të dhënat paraprake të tabelave të statistikave financiare të qeverisë (GFS-Government Finance Statistics) sipas metodologjisë së Fondit Monetar Ndërkombëtar - GFSM2014, të cilat përshtaten nga INSTAT me metodologjinë e Bashkimit Europian - ESA10 për të mundësuar raportimin në EUROSTAT. Të dhënat përfundimtare të GFS-M2014 raportohen në FMN deri në fund të muajit shtator të vitit 2020.

## **VI. MASA ADMINISTRATIVE**

38. Procesi i rakordimit përfundimtar të të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme, si dhe mbyllja e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit, monitorohet nga Nëpunësi i Parë Autorizues nëpërmjet strukturës përgjegjëse për thesarin.
39. Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të përfshirë në proces, do të aplikohen masa administrative sipas shkallës së shkeljes së provuar.
40. Do të aplikohen gjoba nga 1-3 paga mujore deri në largim nga puna mbi të gjithë specialistët e degëve të thesarit që regjistrojnë fatura me datë përpara datës së paraqitjes së tyre në Thesar, apo pa respektuar radhën kronologjike të paraqitjes së faturave nga institucionet në Thesar, pasi shkaktojnë artificialisht krijimin e detyrimeve të prapambetura në sistem.
41. Procedura e ndjekur dhe shpenzimet e regjistruara në SIFQ nga punonjësi i degës së thesarit sipas pikës 18 të këtij udhëzimi do të jetë objekt monitorimi nga Nëpunësi i Parë Autorizues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për shkeljet e konstatuara merret masë administrative deri në largim nga puna të punonjësit të thesarit.
42. Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njërive të qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penaltitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit

Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

43. Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga bankat e nivelit të dytë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë aplikon penalitetet e parashikuara në marrëveshjet me bankat.
44. Për të gjitha kthimet e pagesave elektronike që janë për shkak të:
- Udhëzimeve të gabuara për plotësimin e dokumentacionit të paraqitur në thesar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pagesa e komisionit bankar do të bëhet nga fondet operative të këtyre të fundit, me iniciativë të strukturës përgjegjëse për thesarin, në bazë të procesverbalit të mbajtur midis njësisë shpenzuese dhe degës së thesarit;
  - Regjistrimit të gabuar nga specialisti i degës së thesarit, atëherë pagesa e komisionit do të mbahet nga paga e specialistit;
  - Gabimeve nga banka e nivelit të dytë, atëherë nuk do të paguhet komision, por me bankën përkatëse do të mbahet procesverbal për mosrespektimin e kushteve të marrëveshjes.

Për të gjitha rastet e udhëzimeve të gabuara, banka e nivelit të dytë bën kthimin menjëherë të pagesës së gabuar në Llogarinë Unike të Thesarit, për t’u proceduar me korrigjimin nga degët e thesarit në bashkëpunim me njësinë shpenzuese.

45. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përpilimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e të dhënave periodike të treguesve fiskalë të konsoliduar të buxhetit sipas rregullores së brendshme, të cilat do të përpilojnë raportimin periodik dhe vjetor të ndryshuar.
46. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

